



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.1.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË
KRYEMINISTRIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2017**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Jusuf Kryeziu, (udhëheqës i ekipit) dhe Nora Rashiti Nishefci (anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Zyrës së Kryeministrit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vertetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht 1,118,620€, për projekte të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra shërbime dhe subvencione.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Menaxhmentit auditimi 2017**

Sekretari i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Zyrës së Kryeministrit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e ZKM-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe realizuar/shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuate:

- **Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale.** Në 95 pagesat e testuara me vlerë të përbashkët prej 1,118,620€ nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar për projektet e AUV që i takojnë mallrave dhe shërbimeve si dhe subvencionimit të fermerëve. Këto furnizime si të tilla ishin buxhetuar nga Ministria e Financave duke ndikuar që të mbivlerësohen investimet kapitale dhe të nënvlerësohen mallra dhe shërbimet si dhe subvencionet. Përkundër kërkesave të vazhdueshme nga AUV përgjatë viteve, MF ende nuk kishte ndarë mjetet në kategoritë tjera përkatëse për të shmangur keqklasifikimin aktual të shpenzimeve.

Opinionin ynë nuk është i modifikuar lidhur me çështjet e lartpërmendura.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZKM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ZKM kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipërpërmendura jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it, duhet të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Veprime konkrete duhet të ndërmerren në koordinim edhe më MF, për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve përmes sigurimit të buxhetimit/shpenzimit dhe raportim të drejtë të tyre.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ZKM në vazhdimësi ka treguar gatishmëri në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara. Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah se ZKM ka vendosur kontrole adekuate në shumicën e aktiviteteve operative dhe financiare.

Megjithatë, kontrollet në kategorinë e investimeve kapitale dhe subvencioneve duhet të përmirësohen. Ndërsa kontrollet në fushën e menaxhimit të personelit dhe menaxhimit të të hyrave janë funksionale dhe zbatohen në mënyrë efektive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	14,169,292	15,367,700	13,329,918	11,557,074	9,848,779
Granti i Qeverisë -Buxheti	13,846,748	13,718,334	12,448,459	10,517,645	9,303,190
Të bartura nga viti paraprak ²	-	155,363	88,405	62,827	109,837
Të hyrat vetjake ³	322,544	322,545	222,418	182,180	187,790
Donacionet e brendshme		19,548		-	-
Donacionet e jashtme	-	1,151,910 ⁴	570,636	794,422	247,962

¹ Buxheti Final –buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Organizatës të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet nga entiteti të lejuara për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁴ Buxheti final i donacioneve të jashtme e përfshin edhe vlerën e projektit SIDA “Përkrahje për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë. Për këtë projekt ZKA kryen një auditim të veçantë sipas marrëveshjes ndërmjet ZKA dhe SIDA.

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,198,408€. Në vitin 2017, ZKM ka përdorur 88% të buxhetit final ose 13,029,895€ (pa donacionin SIDA). Pothuaj një realizim i njëjtë me vitin 2016. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit ishte i mirë. Mjetet/donacionet për projektin e financiar nga SIDA janë përfshirë në tabelë 1 dhe 2, mirëpo këto mjete nuk janë përfshirë në shpjegimet/ekzekutimin buxhetor. Për këtë projekt ZKA ka kryer auditim të veçantë sipas marrëveshjes ZKA-SIDA.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	14,169,292	15,367,700	13,329,918	11,557,074	9,848,779
Pagat dhe Mëditjet	3,967,642	4,001,849	3,943,047	4,385,848	4,244,411
Mallrat dhe Shërbimet	3,339,108	3,862,508	2,423,306	2,732,415	2,933,865
Shërbimet komunale	156,548	141,748	84,626	110,677	123,965
Subvencionet dhe Transferet	1,480,000	1,631,870	1,358,085	1,502,811	782,821
Investimet Kapitale	5,225,994	5,729,725	5,520,854	2,825,323	1,763,717

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është rritur për 34,207€. Shuma prej 20,718€ është ndarë donacion nga Qeveria e Norvegjisë për zyrën e komuniteteve në ZKM dhe 13,488€ janë nga të hyrat vetanake të bartura nga viti kaluar të ndara për AVUK. Buxheti për këtë kategori për 2017 është shpenzuar rreth 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime pa donacionin SIDA është 3,275,628€⁵ andaj në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 63,480€. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 64%. Arsyeja për realizimin jo të plotë të buxhetit është se donacionet e brendshme dhe të jashtme janë shpenzuar vetëm 46%;
- Buxheti final për komunal në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 14,800€, edhe pas këtij zvoglumi, buxheti final është shpenzuar rreth 60%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 151,870€, prej tyre vlera prej 15,000€ ishte rritur me vendim të Qeverisë, 9,182€ ishin donacion i brendshëm dhe 127,688€ nga Qeveria e Norvegjisë. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 83%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 503,731€, prej tyre 357,758€ ishte rritur me vendim të Qeverisë, 10,366€ ishte donacion i brendshëm dhe 135,608€ donacione të jashtme. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 96%.

⁵ Buxheti final 3,862,508€, donacioni SIDA 586,880€, buxheti final pa projektin e SIDA 3,275,628€.

3.2 Të hyrat

Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë - AUV është gjeneruesi kryesor i të hyrave. E njëjta, kishte përgatitur planin e të hyrave për vitin 2017 të kategorizuar sipas llojit dhe projeksionet e periudhave të gjenerimit të tyre. AUV, në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave.

Të hyrat e planifikuara të AUV për vitin 2017 janë 5,364,837€, ndërsa realizimi i tyre ishte në vlerë prej 5,696,674€. Gjithashtu Zyra e Kryeministrit për vitin 2017 ka buxhetuar/planifikuar 30,235€ ndërsa janë realizuar 35,235€. Të hyra nga shitja e gazetës zyrtare e Zyrës së Kryeministrit në vlerë prej 30,235€ dhe kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve në vlerë prej 5,000€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat	-	5,395,072	5,731,908	5,743,595	5,627,251
Totali	-	5,395,072	5,731,908	5,743,595	5,627,251

Të hyrat vetjake prej 322,545€ me Ligj të Buxhetit janë lejuar të shpenzohen për nevojat e AUV-it (161,859€ për paga dhe mëditje dhe 160,686€ për mallra dhe shërbime). Prej të hyrave të lejuara janë shpenzuar 222,418€ (161,756€ për paga dhe mëditje dhe 60,662€ për mallra dhe shërbime).

Në kategorinë e të hyrave kemi testuar 40 mostra/pagesa si teste substanciale si dhe 5 mostra në të cilat kemi aplikuar teste te pajtueshmërisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat, si dhe menaxhimi i personelit

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrolltet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e ZKM-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar afro 99% të buxhetit final. Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 3,417,376€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,207,909€. Ato kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime 2,123,282€ dhe shpenzime komunale 84,626€. Në këtë kategori ishin shpenzuar rreth 65% të buxhetit final. Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe si rezultat i ekzaminimit doli që:

Çështja 2 - Kontrata për shërbime të veçanta

- E gjetura** Sipas nenit 12 pika 4 e Ligjit për Shërbimin Civil (LShC), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.
- AUV kishte lidhur marrëveshje pa ndonjë procedurë të rekrutimit për pozitën *Inspektor Fitosanitar* me kohëzgjatje për tre muaj. Pagesat për këtë periudhë janë 1,332€. Kjo mënyrë e aplikuar nga AUV nuk ishte në përputhje me dispozitat e përcaktuara ligjore.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave përmes procedurave jo adekuate paraqet anashkalim të dispozitave të përcaktuara ligjore, si dhe mund të ketë ndikim në klasifikimin/raportimin jo të drejtë financiar sipas kategorive ekonomike.
- Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të përmirësoj nivelin e kontroleve në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj transparencë dhe zbatueshmeri të legjislacionit në angazhimin/rekrutimin e stafit.

Çështja 3 – Mos nënshkrimi i raportit i vlerësimit të tenderit nga zyrtari i prokurimit

- E gjetura** Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, zyrtari i prokurimit duhet të shqyrton propozimin për kontratë të vlerësuar nga Komisioni i vlerësimit. Në kontratën “Furnizim me pajisje të IT-së” në AUV, në vlerë prej 19,882€, kemi vërejtur se raporti i vlerësimit për këtë tender nuk ishte i nënshkruar nga zyrtari i prokurimit. Sipas zyrtarit të prokurimit, kjo kishte ndodhur si pasojë e mos kujdesit të duhur.
- Rreziku** Mos nënshkrimi i raportit të vlerësimit të tenderit, rrezikon që i tërë procesi i vlerësimit të mos monitorohet nga zyrtari i prokurimit si rezultat i të cilës mund të devijoj nga karakteristikat, kushtet si dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin ekzekutiv të AUV-it, duhet të forcojnë kontrollet në fushën e prokurimit, duke siguruar që çdo raport i vlerësimit të procesit tenderues të jetë i rishikuar/monitoruar dhe i nënshkruar nga Zyrtari i prokurimit.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,631,870€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 1,358,085€ apo rreth 83% të buxhetit final. Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, si rrjedhojë kemi çështjet vijuese:

Çështja 4 - Menaxhim jo i duhur i subvencioneve në ZKM

E gjetura

Qëllimi i programit për Komunitete është ndarja e subvencioneve dhe transfereve me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve që operojnë në vend. Përfituesit janë të detyruar të dorëzojnë raport narrativ për ecurinë e projektit dhe të ofrojnë dëshmi relevante për realizimin e projektit. Ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- **Raportim i dobët për shfrytëzimin e subvencioneve dhe arsytim jo i plotë i tyre.** Në nëntë raste me vlerë në total prej 37,500€ kemi identifikuar që ishin të mangëta dëshmitë mbështetëse për shfrytëzimin e subvencioneve të dhëna nga Zyra për çështje të Komuniteteve, sepse mungonin raportet narrative, faturat dhe raportet financiare kthyes;
- **Mangësi në vlerësimin e projektit.** Në një rast, kërkesa e bërë në Zyrën për Çështje të Komuniteteve nuk ishte e nënshkruar nga aplikanti, ndërsa ishte e protokoluar nga ZKM. Ky person fizik ishte subvencionuar në vlerë prej 1,500€;
- **Mos respektimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Komunitetet Përkatëse (Novobërdë dhe Kllokot).** Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZçK) në kuadër të ZKM-së kishte lidhur dy Memorandume të Mirëkuptimit (MiM) me Komunitetet Përkatëse për financimin e projekteve në vlerë prej 54,102€. Përderisa Komunitetet obligohen që të zhvillojnë procedurat e prokurimit duke përzgjedhur operatorin ekonomik.

Si pjesë e marrëveshjes, ZçK do ta ketë një përfaqësues në grupin punues gjatë procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave. Ne, kemi vërejtur se hapja, vlerësimi i procesit tenderues si dhe pranimi i situacionit ishin bërë në mungesë të ndonjë zyrtari përfaqësues nga ana e ZKM-së. Kjo po ashtu kishte ndikuar në keqklasifikimin e kodit ekonomik. Është paguar nga kodi 21200 (Subvencionet për entitete jopublike) ndërsa është dashur të paguhet nga 33100 (Transfere kapitale për entitete publike).

Rreziku

Mangësitë e paraqitura në procesin e dhënies, shfrytëzimit dhe realizimit të subvencioneve e rrisin rrezikun rreth shpenzimit jo të drejtë të parasë publike si dhe mos arritjen e objektivave të parapara me subvencion.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në fushën e subvencioneve duke vendosur kontrole përkatëse në realizimin e tyre. Të siguroj rritjen e aktiviteteve monitoruese, për të mundësuar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin për mënyrën e shfrytëzimit të tyre, duke siguruar që qëllimet e synuara përmes subvencioneve janë arritur.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,729,725€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 5,520,854€, ose 96%. Në këtë kategori kemi ekzaminuar disa mostra, kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave doli që:

Çështja 5 - Pagesë e dyfishtë e bërë ndaj fermerit

E gjetura Me vendim të Qeverisë është aprovuar kompensimi i fermerëve vendor për dëmin e pësuar me rastin e ngordhjes së kafshëve/gjedheve nga sëmundja gungore e lëkurës (LSD) gjatë vitit 2016. Kompensimi i fermerëve për krerë gjedhe/kafshë të ngordhura është bërë në bazë të vlerësimit të përcaktuar nga Komisioni i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të ndara sipas kategorive: lopët - 1,200€ për krerë, viçat - 500€ për krerë, dhe demat/mëshjtjerrat - 800€ për krerë.

AUV ka bërë zbatimin e këtij vendimi duke paguar fermerët në bazë të tri listave të aprovuara nga Komisioni për vlerësimin e dëmit të fermerëve. Nga 46 raste të audituara në vlerë prej 60,200€, në tri raste me vlerë prej 7,200€ kemi hasur në parregullsi ku ishin dyfishuar pagesat ndaj fermerëve. Fermerët janë kompensuar/paguar nga 2,400€ për gjedh, përderisa vlera e duhur për kompensim/pagesë ishte 1,200€ për gjedh. Zyrtarët përgjegjës për këtë çështje, janë deklaruar se kjo ka ardhur si rezultat i gabimit nga ana e Komisionit të vlerësimit. Gjithashtu, pas pranimit të draftit, sipas zyrtarëve përgjegjës të AUV-it, kryeshefi i Agjencionit ka ndërmarrë masat përkatëse lidhur me këto raste duke nxjerrë disa vendime me të cilat obligon fermerët që në afat prej 30 ditësh t'i kthejnë mjetet e pranuar në buxhetin e AUV-it.

Rreziku Realizimi i pagesave të tilla, përveç se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, njëkohësisht e rrit rrezikun e humbjeve të buxhetit dhe mosrealizimit të objektivave të organizatës në përgjithësi. Gjithashtu kjo çështje mund të ndikoj në dëmtimin e reputacionit të Agjencionit të Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it, duhet të ndërmarrin hapa të duhur për forcimin e kontroleve në këtë fushë të realizimit të shpenzimeve, duke siguruar transparencë dhe pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara më LMFPF-në, rregullat e Thesarit dhe vendimet përkatëse.

Çështja 6 - Mangësi në procesimin e urdhërblërjeve

- E gjetura** Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blërja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.
- Në 32 raste me vlerë në total prej 363,190€ urdhërblërjet janë procesuar pas pranimit të faturës. Këto raste kishin ndodhur tek pagesa për shërbime të identifikimit, regjistrimit dhe asgjësimit të kafshëve, matrikulimin e gjedheve dhe analizave laboratorike. Kjo ka ndodhur ngase ka munguar monitorimi i këtij procesi dhe nuk janë zbatuar rregullat e Thesarit.
- Rreziku** Pranimi i mallrave dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, e rrit rrezikun që të pranohen mallrat të cilësisë dhe sasisë jo të duhura.
- Rekomandimi 6** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të forcojnë kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPN-në dhe me rregullat e Thesarit.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 7 - Mospërputhje në mes planit të prokurimit dhe realizimit të kontratave

- E gjetura** Në AUV, kemi hasur pesë raste, që janë realizuar procedura në të cilat janë kontraktuar shërbime/furnizime pa qenë të planifikuara në prokurim. Prej tyre, tri raste në vlerë prej 2,889€, i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve (procedura me vlerë minimale) dhe dy raste i takojnë kategorisë së investimeve kapitale në vlerë prej 124,920€.
- Rreziku** Mosplanifikimi i saktë i prokurimit mund të rrezikon arritjen e qëllimeve të Organizatës dhe duke shkaktuar kosto shtesë të prokurimit. Po ashtu rrezikon edhe buxhetin në disponueshmëri për vitin aktual si dhe vitin e ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshëfin Ekzekutiv të AUV-it duhet të ngrisin kontrollet për të siguruar që të planifikohet dhe analizohen më në detaje buxhetet për aktivitetet e prokurimit ashtu siç parashihet me Ligjin e prokurimit publik dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 4,939,345€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale nën 1000€ ishte 246,254€ si dhe stoqet në vlerë prej 75,553€. Nga testimet tona identifikuam parregullsitë si në vijim:

Çështja 8 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë të ZKM-së dhe AUV-it

E gjetura Sipas neni 16 të rregullës së MF-së, Nr.02/2013, Zyrtari i Pasurisë jo Financiare do të jetë përgjegjës për evidentimin, përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive me të gjitha informatat që kërkohen në dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe ligjeve tjera në fuqi. Zyrtari i pasurisë jo financiare do t'i regjistrojë në mënyrën e duhur të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se pasuria është në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore.

Në ZKM, kemi vërejtur se pasuritë e blera në vitin 2017 në vlerë prej 2,696€ (10 pajisje-furnizime për zyrë) të financuara nga donacioni SIDA, nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive të ZKM-së.

Më tej, mangësi kishte edhe në përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive. Në AUV, në regjistrin e pasurive-pasuritë kapitale mbi 1000€ në thesar/SIMFK ishte regjistruar një pasuri (veturë) me vlerë prej 14,840€, përderisa zyrtari i pasurisë nuk ka mundur të na ofroj dëshmi për dokumentacionin mbështetës të kësaj veture dhe ekzistencën e saj fizike. Sipas zyrtarit të pasurisë kjo veturë është regjistruar gabim në regjistër të pasurisë, e cila sipas tij ishte dyfishim në regjistrimin e veturës së njëjtë të blerë në vitin 2014.

Rreziku Kontrolllet e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi në këtë komponent të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 8 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet t'i rishikojnë kontrollat ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollat në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si duhet dhe të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi.

3.9 Të arkëtueshmet

Sipas PFV-ve 2017, ZKM ka prezantuar të arkëtueshme në vlerë prej 37,197€, këto të arkëtueshme i takojnë AUV-it. Përderisa, në fund të 2016 të arkëtueshmet ishin 36,157€. Nga testimet tona identifikuar parregullësitë si në vijim:

Çështja 9 – Mangësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve

E gjetura Sipas rregullores së Qeverisë nr.17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kreu II neni 5, thuhet qartë: Parashtruesi i aplikacionit është i obliguar që aplikacionit për shërbime t'ia bashkëngjisë dëshminë e pagesës. Dhe, po që se parashtruesi i aplikacionit nuk bashkëngjitë dëshminë e pagesës, agjencia nuk do të veprojë sipas aplikacionit deri me pranimin e dëshmisë për pagesë (përveç inspektimit sanitar brenda vendit – therja e kafshëve e cila rregullohet me vendim). Përkundër kësaj, në dy raste kemi vërejtur që AUV ka kryer shërbime pa siguruar dëshminë për pagesat e kryera.

Më tej, llogaritë e arkëtueshme janë prezantuar në PFV, në vlerë prej 37,197€. Prej tyre, vlera prej 19,383€ është prezantuar edhe në regjistrin e të hyrave (në Thesar/SIMFK-të hyra në tranzit) edhe në PFV. Si rezultat i kësaj të dhënave/hyrat e prezantuara në PFV dhe Thesar janë dyfishuar për vlerën 19,383€.

Gjithashtu, nga 10 mostra të ekzaminuara në tetë prej tyre në vlerë prej 2,853€, doli që pagesat janë kryer muajin dhjetor/2017, përderisa të njëjtat ishin edhe në listën e llogarive të arkëtueshme të prezantuar më 31.12.2017 në pritje për tu arkëtuar në vitin 2018.

Rreziku Realizimi i shërbimeve pa u kryer pagesa përveç se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, njëkohësisht e rrit rrezikun për mos inkasim të plotë dhe në kohë si dhe krijon trajtim jo të barabartë për debitorët e tjerë. Ndërsa, mangësitë e paraqitura në menaxhimin e të arkëtueshmeve tregojnë qartë nevojën për përmirësim dhe forcim të kontrolleve në këtë fushë. Prezantimi dhe dyfishimi i të dhënave në të hyra dhe të arkëtueshme, e zbeh besueshmërinë e të dhënave të prezantuara në PFV.

Rekomandimi 9 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, dhe raportimit e saktë të tyre, duke siguruar pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuar me legjislacionin në fuqi si dhe të siguroj prezantim/shpalosje të saktë në PVF.

3.10 Obligimet e papaguara

ZKM, në PFV-të e vitit 2017 ka shpalosur obligimet e papaguara në vlerë prej 652,140€, përdërisa në fund të vitit 2016 obligimet e papaguara kanë qenë në vlerë prej 223,754€. Në këtë kategori kemi ekzaminuar disa mostra dhe si rezultat doli që:

Çështja 10 - Rritja e obligimeve të pa paguara

E gjetura Obligimet e pa paguara në fillim të vitit 2017 ishin 223,754€, deri në fund të këtij viti obligimet janë rritur afërsisht tri herë më tepër. Vlera e tyre me 31 dhjetor 2017 është 652,140€. Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara i takojnë AUV-it apo vlera prej 521,259€, që kanë të bëjnë me shpenzime për analiza jashtë vendi, vaksinim i kafshëve, kompensim i fermerëve dhe analiza laboratorike. Sipas zyrtarëve përgjegjës arsye kryesore e rritjes së obligimeve ishte mungesa e buxhetit dhe pranimi i faturave pas mbylljes së zotimeve.

Rreziku Rritja e obligimeve të papaguara është indikator për menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal dhe ndikon në buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 10 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet operative dhe financiare aty ku është e mundur të zhvillohen para muajit dhjetor.

Çështja 11 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave dhe raportime jo të plota të obligimeve

E gjetura Sipas rregullores 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, Organizata Buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimi të faturës. Gjithashtu, OB janë të obliguara që në Ministrinë e Financave të raportojnë në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara. Në dy raste kemi vërejtur që faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 1,229€ nuk ishin paguar brenda afatit prej 30 ditësh. Gjithashtu të njëjtat nuk ishin përfshirë në raportet mujore të obligimeve.

Rreziku Vonesat në ekzekutimin e pagesave, e rrit rrezikun për krijimin e shpenzimeve shtesë të cilat mund të rezultojnë nga ndëshkimet dhe kamatat nga furnitorët, si dhe rritjen e obligimeve të pa paguara në fund të vitit. Gjithashtu edhe mos raportimet e obligimeve e rrisin rrezikun që organizata të hyjë në obligime pa buxhet duke shkaktuar vështirësi buxhetore në fund të vitit.

Rekomandimi 11 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor, si dhe të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara bëhet i plotë dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

Çështja 12 - Detyrimet Kontingjente

- E gjetura** Detyrimet kontingjente janë rritur dukshëm në vitin 2017 krahasuar me ato të vitit 2016. Më 31.12.2017 janë prezantuar 853,124€ ndërsa me 31.12.2016 ishin 77,163€. Detyrimet kontingjente i takojnë AUV-it dhe janë ofruar dëshmi mbështetëse që organizata është paditur për këto raste. Pretendimet në vlerë financiare janë pasqyruar në PFV 2017. Përveç detyrimeve kontingjente të prezantuara nga organizata, ekzistojnë edhe disa raste të tjera në listat e Avokatit Shtetëror, ku për këto raste ZKM nuk kishte informata.
- Rreziku** Mungesa e një qasje adekuate për trajtimin e detyrimeve kontingjente rrit mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime faktike që do të shkaktonte keqësimin e pozitës financiare të organizatës.
- Rekomandimi 12** Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it duhet të sigurojnë se detyrimet kontingjente trajtohen me kujdes, të analizojnë shkaqet e ndodhjes se tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Në koordinim më Avokatin Shtetëror të sigurohen informata/dëshmi që të sigurohet përfaqësim adekuat i këtyre rasteve/lendeve.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016, ka rezultuar me 18 rekomandime. ZKM ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet zbatohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tetë rekomandime janë zbatuar plotësisht, derisa katër janë në proces të zbatimit (pjesërisht adresuar) si dhe gjashtë nuk janë adresuar. Po ashtu edhe nga viti 2015 janë pesë rekomandime të pa zbatuara. Çështjet që janë përsëritur nga vitet e kaluara janë mangësitë në dhënien/shpërndarjen e subvencioneve, klasifikimi i shpenzimeve, mangësi në menaxhimin e pasurive, vonesat në realizimin/ekzekutimin e faturave të papaguara dhe raportimin e tyre në raportet mujore në MF. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 13 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak

- E gjetura** Prej pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016, menaxhmenti i ZKM-së ka ndërmarrë masa për t'i adresuar çështjet e ngritura. Ne veçanti ka progres sa i përket adresimit të rekomandimeve në fushën e prokurimeve. Megjithatë, ka mungesë të zbatimit të plotë dhe mangësi të njëjta vërehen në klasifikimin e shpenzimeve, raportimin e përfituesve të subvencioneve, menaxhimin e pasurive dhe menaxhimin e obligimeve. Më tej, për çështje/fusha të ngjashme është rekomanduar edhe në vitin 2015, por ka ngecje në zbatimin e tyre.
- Rreziku** Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuar, dhe si rezultat në vazhdimësi kemi përsëritjen e mangësive të njëjta.
- Rekomandimi 13** Sekretari i përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk implementohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ZKM në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në ZKM në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. ZKM ka zbatuar një pjesën të rekomandimeve dhe është në proces të zbatimit të rekomandimeve tjera. Ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Ne duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në vazhdimësi tregon një cilësi të lartë të punës përmes së cilës jep vlerësime të qëndrueshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti i ZKM-së për përmirësimin e fushave me mangësi të theksuara.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. ZKM ka arritur të realizoj rreth 88% buxhetin final për vitin 2017.

Më tutje, performanca e menaxhimit të shpenzimeve përveç keqklasifikimeve në kategorinë e kapitaleve, këtë vit është përmirësuar edhe më tej në raport me vitet tjera. Megjithatë në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshinë kryesisht prokurimin, mos raportimin e përfituesve të subvencioneve, llogaritë e arketueshme, obligimet si dhe menaxhimin e pasurive.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

ZKM ka njësinë e auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi e cila përbëhet nga drejtori i njësisë së auditimit të Brendshëm (NjAB).

Njësia e auditimit të brendshëm për 2017 ka planifikuar katër auditime, prej të cilave të gjitha janë kryer deri në fund të vitit 2017. ZKM kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe është në proces në implementimin e tyre. Gjithashtu NJAB ka përgatitur raporte tremujore për aktivitetet e saj në NJQHAB në MF. Edhe AUV e ka të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm e cila është funksionale dhe është e përberë nga një auditor.

Çështja 14 - Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime nga NjAB

E gjetura Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë cilësore dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm. Megjithatë, auditimet e finalizuara nuk kishin mbuluar aktivitetet e vitit aktual, por në përgjithësi/kryesisht ishin fokusuar në aktivitetet e vitit 2016.

Rreziku Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime nga NjAB zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare për Zyrën e Kryeministrit.

Rekomandimi 14 Sekretari i Përgjithshëm së bashku me Kryeshefin Ekzekutiv të AUV-it, në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti i ZKM-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e saj. Gjithashtu, ZKM është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive të saj vartëse. Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Kryeministri apo Zëvendës Kryeministri përkatës, derisa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për konsolidimin e pasqyrave financiare. Për qëllime të konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare, agjencitë dërgojnë raporte në departamentin e financave në ZKM.

Gjithashtu, ZKM kishte treguar progres lidhur me proceset e menaxhimit të rrezikut krahasuar me vitin e kaluar, e cila ka krijuar regjistrin e rreziqeve duke i identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	<p>Çështja 1- Mungesa e dëshmive për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve - Prioritet i lartë</p> <p>ZKA në bashkëpunim me Drejtorin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve duhet të forcojë edhe më tutje kontrollet mbi subvencione duke implementuar dhe aplikuar kërkesa strikte për dëshmitë që duhet të ofrohen nga përfituesit me rastin e pranimit të mjeteve të subvencionit. Duhet ti jepet konsideratë edhe vendosjes së kërkesës ndaj përfituesve për kthimin e fondeve në rastet ku nuk janë ofruar dëshmi të përshtatshme/duhura.</p>			Nuk është zbatuar.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	<p>Çështja 2 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë</p> <p>ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive duhet ta prioritetizojnë implementimin e rekomandimeve të auditimit dhe të sigurohen se një plan veprimi menaxhohet në mënyrë proaktive dhe i cili detajon stafin përgjegjës dhe orarin për implementimin e secilit nga rekomandimet. Implementimi i planit të veprimit duhet të rishikohet nga ZKA në baza mujore.</p>			Nuk është zbatuar.

1.2 Opinioni i Auditimit	<p>Theksimi i çështjes</p> <p>Nga kategoria e investimeve kapitale gjatë vitit ishin paguar 1,763,717€, për projektet e AUV-it, të gjitha këto furnizime ishin me artikuj për mallra dhe shërbime si dhe subvencionim i fermerve. Kjo gjendje është shpalosur edhe në PVF;</p> <p>ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it duhet të insistojnë edhe më tutje, që në bashkëpunim me MF-në të kërkojnë zgjidhje për keqklasifikimin aktual të shpenzimeve</p>			Nuk është zbatuar.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	<p>Çështja 15- Raportimi jo i saktë i pasurive- Prioritet i lartë</p> <p>ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet ta vlerësojnë qartë çdo mangësi në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive dhe të marrin në konsideratë se si mund të adresohen këto çështje. Procedurat e përmirësuara dhe një prioritizim i kohës së stafit duhet të zbatohet për të siguruar që e-pasuria është azhurnuar dhe të barazohet me regjistrat e pasurisë.</p>			Nuk është zbatuar.
3.7.2 Trajtimi i borxheve	<p>Çështja 17 - Menaxhim jo i duhur i obligimeve - Prioritet i mesëm</p> <p>ZKA dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të forcojnë mekanizmat e kontrollit në mënyrë që obligimet të paguhen brenda afatit ligjor dhe të regjistrohen saktë dhe raportohen tek MF me kohë.</p>			Nuk është zbatuar.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.1 Opinioni i auditimit	<p>Çështja 1 - Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të sigurojnë se kanë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të arsyetuar shpenzimet e dhëna për subvencione për tu siguruar se mjetet janë shpenzuar për qëllimet e dhëna, si dhe të vazhdojë përpjekjet përmes kërkesave në MF që mjetet të buxhetohen sipas kategorisë përkatëse.</p>			Nuk është zbatuar.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	<p>Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se do ndërmerren veprime shtesë me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme dhe aty ku rekomandimet janë përsëritur. Një monitorim sistematik nga ana e menaxhmentit është i nevojshëm për të siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve dhe brenda afateve të përcaktuara.</p>		Menaxhmenti i ZKM-së ka ndërmarrë masa për t'i adresuar çështjet e ngritura. Ne veçanti ka progres sa i përket adresimit të rekomandimeve në fushën e prokurimeve. Megjithatë, ka mungesë të implementimit të plotë dhe mangësi të njëjta vërehen në klasifikimin e shpenzimeve, raportimin e përfituesve të subvencioneve, menaxhimin e pasurive dhe menaxhimin e obligimeve.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	<p>Çështja 3 - Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të aplikojnë një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në pyetësin e vet-vlerësimit.</p>	Është zbatuar.		
2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	<p>Çështja 4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi Agjencitë, në mënyrë që të përcaktohen rregulla të qarta të raportimit formal rreth aktiviteteve operative dhe financiare, për të mbështetur menaxhimin efektiv të proceseve dhe aktiviteteve të ZKM-së.</p>	Është zbatuar.		
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	<p>Çështja 5 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-it – Prioriteti i lartë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë me NjAB-në dhe KA-në për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.</p>		Të gjeturat dhe rekomandimet janë diskutuar në takimet me komitetin e auditimit, gjithashtu menaxhmenti ka përgatitur planin aksional për implementimin e rekomandimeve, dhe janë në proces të implementimit të tyre. Më tej, janë realizuar dy auditime me objektiv implementimi i rekomandimeve dhe si rezultat i këtyre auditimeve ka dalë që ka progres në implementimin e tyre.	

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	<p>Çështja 6 - Lidhja e kontratave për shërbime të veçanta në kundërshtim me ligjin për shërbyes civil - Prioritet i mesëm.</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm dhe Krye shefat e ASK-së dhe ASHAK-ut duhet të sigurojnë se angazhimi me marrëveshje për shërbime të veçanta bëhet në përputhje me kërkesat e LSHC-së, duke zbatuar një procedurë të thjeshtuar të rekrutimit dhe në kohëzgjatje më të shkurtër se gjashtë (6) muaj. Për më tepër të ndërprehet praktika e angazhimit të zyrtareve brenda institucionit me marrëveshje të veçanta.</p>			Nuk është zbatuar.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	<p>Çështja 7 - Mangësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i lartë</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të sigurojnë se kanë shtuar kontrollet mbi proceset e prokurimit në veçanti sa i përket ndarjes së kërkesave të prokurimit, respektimit të kriterëve të dosjes së tenderit, kërimit të sqarimeve dhe vlerësimit të tyre në rastet e tenderëve jo normalisht të ulët. Më tutje, të sigurohet se nuk do të lejohet vazhdimi i kontratave publike kornizë si dhe do të respektohet parimi i ndarjes së detyrave.</p>	Është zbatuar.		
	<p>Çështja 8 - Kompensimi shtesë i punonjësve - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e ASK-së duhet të sigurojë se do të respektohen dispozitat e LMFPD dhe nuk do lejohet kurrfarë kompensimi shtesë i punonjësve për angazhimet brenda orarit të rregullt të punës dhe se kompensimi i punëtorëve bëhet vetëm nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.</p>	Është zbatuar.		

	<p>Çështja 9 - Pagesa për furnizim me bileta pa dëshmi të mjaftueshme - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të shtojë kontrollin për t'u siguruar se aprovimi i shpenzimeve për furnizim me bileta bëhet vetëm pas sigurimit të dëshmimeve të mjaftueshme të cilat do të mundësonin verifikimin e çmimit të biletave nëse janë në përputhje me kontratën.</p>	Është zbatuar.		
	<p>Çështja 10 - Vonesa në mbylljen e avanseve - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të ngrisë nivelin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë tek zyrtarët përgjegjës duke kërkuar që dëshmitë për arsyetimin e shpenzimeve të udhëtimit të ofrohen me kohë dhe procedurat e duhura për mbylljen e avanseve të kryhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.</p>		Ne kemi ekzaminuar disa raste në këtë kategori dhe ka rezultuar që avancet janë mbyllur, mirëpo në pasqyra financiare janë prezantuar disa raste për avancet e pambyllura.	
	<p>Çështja 11 - Kontrollle të dobëta në procesin e pranimit të pasurisë - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e furnizimeve me pasuri jo financiare do të formojë komisionin në përputhje me rregulloren e cili do të bëjë verifikimin e karakteristikave të pasurisë së pranuar në mënyrë që të pranimit të pasurive të jetë në përputhje të plotë me kontratën.</p>	Është zbatuar.		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	<p>Çështja 12 - Regjistrimi i shpenzimeve në nën kode ekonomike jo adekuate - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kode ekonomike përkatëse</p>			Nuk është zbatuar.

<p>3.1.4 Subvencionet dhe Transferet</p>	<p>Çështja 13 - Ndarja e subvencioneve pa kriteret të qarta - Prioritet i lartë Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë hartimin dhe aprovimin e një rregulloreje, e cila do të përcaktonte kriteret e përzgjedhjes, si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit për t'u siguruar se subvencioni ka arritur qëllimin për të cilin është dhënë.</p> <p>Çështja 14 - Dobësi në shpërndarjen e subvencioneve - Prioritet i mesëm Sekretari i Përgjithshëm nëpërmjet të ZÇK-së duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve bëhet në përputhje me programin e aprovuar për komunitete.</p> <p>Çështja 15 - Mos respektim i marrëveshjeve të përcaktuara dhe keq klasifikim i shpenzimeve Sekretari i Përgjithshëm nëpërmjet ZÇK-së duhet të sigurojë se janë plotësuar kushtet e marrëveshjes që kanë të bëjnë me caktimin e përfaqësuesve të ZKM-së në komisionet përkatëse. Më tutje, të sigurojë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kode ekonomike përkatëse.</p>	<p>Është zbatuar.</p>		<p>Nuk është zbatuar.</p> <p>Nuk është zbatuar.</p>
--	--	---------------------------	--	---

3.2 Pasuritë	<p>Çështja 16 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm dhe kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kanë forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë e që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Çështja 17 - Mungesa e evidencave të plota për përdorimin e automjeteve - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrole efektive në menaxhimin e automjeteve për të parandaluar përdorimin e tyre pa evidentimin e arsyeshmërisë, qëllimit, destinimit, kilometrave dhe karburanteve të shpenzuara. Këto kontrole do të ndikojnë në përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve.</p>	Është zbatuar.	Edhe pse kishte progres në menaxhimin e pasurive, ende mbetet sfida për ZKM-në menaxhimi i kësaj komponente. Këtë vit kryesisht kishte mangësi në regjistrimin e pasurive dhe azhurnimin e këtyre regjistrave.	
3.3 Obligimet e papaguara	<p>Çështja 18 - Vonesat në pagesa si dhe mos raportimi i obligimeve - Prioritet i mesëm</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor, si dhe raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 04/2011 për raportimin e obligimeve të papaguara.</p>			Nuk është zbatuar.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO ZYRA E Kryeministrit - UREDI Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Niveli/Org. Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot.
01	1543/3
Nr. fletëve No pages	Data: Date:
- 1 -	16 / 05 / 2018
Prishtinë / a	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRILAVUR/RECEIVED:		29.05.2018	
Niveli/Org. Org./Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. fletëve Br. Stranica No. Pages
400	03	817	1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Fitim Krasniqi

Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës,
Data: 15.05.2018, Prishtinë